


TË MBROJMË PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA GJATË PANDEMISË COVID-19

Është jetike që gjithsecili të ndjekë masat themelore me qëllim mbrojtjen e vetvetes dhe të tjerëve nga sëmurja me COVID-19. Më se 100 milionë persona me aftësi të kufizuara jetojnë në rajonin e Mesdheut Lindor të OBSH-së. të gjithë ofruesit e shërbimeve duhet të garantojnë që ata të trajtohen me respekt dhe dinjitet dhe pa diskriminim, si dhe që të mos lihen pas gjatë kësaj kohe sfiduese.



PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DUHET:

- Të shmangin ambientet dhe transportin me shumë njerëz aty ku është e mundur.
- Të grumbullojnë ushqime, ilaçe dhe produkte të tjera thelbësore të mjaftueshme, për të paktën dy javë.
- Të bëjnë pazarin online apo me anë të hotline-ve aty ku është e mundur dhe t'u kërkojnë ndihmë të afërmve, miqve apo punonjësve të përkujdesjes.
- Të pastrojnë dhe të dezinfektojnë rregullisht produktet ndihmëse sikurse janë karriget me rrota, shkopinj të bardhë, etj.
- Të hartojnë një plan për të garantuar vazhdimësinë e përkujdesjes dhe të mbështetjes.
- Të identifikojnë organizata, shërbime telefonike dhe persona të cilëve mund t'u kërkohet asistencë, në rast nevojë.

PUNONJËSET E PËRKUJDESJES DUHET:

- T'i thonë personit për të cilin përkujdesen apo të afërmve të tij të kërkojnë ndihmë mjekësore në kohë nëse kanë simptoma të COVID-19.
- Në rast se dyshoni se personi për të cilin përkujdeseni ka simptoma të COVID-19, mbani maskë mjekësore, lani duart mirë dhe kërkon ndihmë mjekësore menjëherë.
- Sigurohuni që çdo produkt ndihmës të pastrohet dhe dezinfektohet rregullisht.
- Të mbani një listë shërbimesh publike dhe organizatash komunitare që mund të ofrojnë ndihmë.
- Të planifikoni që më parë së bashku me personin për të cilin përkujdeseni me qëllim garantimin e vijimësisë së përkujdesjes, përfshi mjekimin dhe furnizimet, kujdesin mjekësor shtesë, mbështetjen psikosociale dhe atë të shëndetit mendor, si dhe çdo kërkesë tjetër të tilla si riparimi apo zëvendësimi i produkteve ndihmëse.

QEVERITË DUHET:

- Të garantojnë që të gjitha ambientet e kujdesit mjekësor të jenë të aksesueshme, përfshi shërbimet e testimit dhe të izolimit.
- Të bëjnë të aksesueshme të gjitha informacionet për shëndetin publik për personat me të gjitha format e aftësisë së kufizuar.
- Të angazhojnë personat me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e tyre në planifikimin e reagimit ndaj pandemisë.
- Të garantojnë që skemat e kompensimit financiar të mbulojnë personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ofrojnë ambiente pune fleksibël për ta, të afërmit dhe personat që përkujdesen për ta.
- Të garantojnë vijimësinë e shërbimeve dhe mbështetjes në rast se numri i disponueshëm i punonjësve të përkujdesjes mund të zvogëlohet, përfshi mundësi trajnimi të përshpejtuar për fuqinë e re punëtore.
- Të sigurojnë hotline në formate të shumëllojshme (p.sh. telefonike, me email, SMS, aplikacione me gjuhë të thjeshtuar, etj.) ku personat me aftësi të kufizuar të mund të bëjnë pyetje dhe të ngrenë shqetësime.
- Të garantojnë që ofruesit e shërbimeve dhe punonjësit e përkujdesjes për personat me aftësi të kufizuara të kenë akses në pajisjet personale mbrojtëse dhe testim falas për COVID-19.



Funded by the European Union

TË MBROJMË PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA GJATË PANDEMISË COVID-19

PUNONJËSIT E SHËNDETËSISË DUHET:

- Të adoptojnë mënyra alternative të ofrimit të kujdesit shëndetësor, si vizita në banesë, konsulta telefonike dhe videokonferenca, me qëllim sigurimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.
- Të shpërndajnë informacione dhe të komunikojnë në formate të diversifikuara në përshtatje me nevojat e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara të ndryshme. Të mos mbështeten vetëm në informacione me gojë apo me shkrim.
- Të ofrojnë mbështetje të mjaftueshme për personat me aftësi të kufizuara me nevoja më komplekse.
- Të garantojnë që punonjësit e shëndetësisë të jenë të vetëdijshëm për ndikimin potencial të COVID-19 mbi shëndetin dhe kushtet e jetesës të personave me aftësi të kufizuara.

OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË AFTËSISË SË KUFIZUAR DUHET:

- Të zhvillojnë dhe të zbatojnë plane për vijimësinë e shërbimeve në konsultim me personat me aftësi të kufizuara, të afërmit e tyre dhe agjenci të tjera të aftësisë së kufizuar dhe të përkujdesjes shoqërore.
- Në rast mungese burimesh për planet për vijimësinë e shërbimeve, të marrin në konsideratë angazhimin e komunitetit dhe kërkimin e mbështetjes shtesë, veçanërisht nga persona që vijnë nga fushat përkatëse (p.sh. infermieri, fizioterapi, terapi okupacionale).
- Të komunikojnë shpesh me personat me aftësi të kufizuara dhe rrjetet e tyre mbështetëse, me qëllim sigurimin e informacioneve të posaçme për COVID-19, duke u siguruar që të gjitha informacionet të jenë të aksesueshme.
- Të trajnojnë fuqinë punëtore në fushën e aftësisë së kufizuar lidhur me parandalimin dhe kontrollimin e infektimit.
- Të vijojnë ofrimin e mbështetjes së mjaftueshme për personat me aftësi të kufizuara me nevoja komplekse.

VEPRIMET PËR KOMUNITETIN:

- Të krijohen ambiente pune fleksibël për personat me aftësi të kufizuara dhe punonjësit e përkujdesjes, përfshi dhënien e lejeve të paguara në rast se ata gjenden në rrezik të lartë nga simptomat e rënda.
- Të rritet aksesin në njësitë tregtare dhe të përcaktohen orë të caktuara pazari për personat me aftësi të kufizuara.
- Shkollat dhe objektet e tjera arsimore duhet të ndërmarrin veprime të përshtatshme për të garantuar vijimësinë e arsimit për personat dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Të afërmit, miqtë dhe fqinjët duhet të kontrollojnë rregullisht personat me aftësi të kufizuara për të ofruar mbështetje emocionale, praktike dhe komunikuese.

MBROJTJA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË KRIZAT HUMANITARE DHE KUSHTET E EMERGJENCËS

Shumica e vendeve në rajon preken drejtpërdrejt apo tërthorazi nga emergjencat e ndryshme, ndërsa COVID-19 paraqet sfida shtesë. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit dhe të mbrojtjes së shëndetit duhet të garantojnë që personat me aftësi të kufizuara të përfshihen në të gjitha planet e gatishmërisë dhe reagimit në rast emergjencash, dhe që shërbimet riaftësuese dhe produktet ndihmëse të vijojnë të ofrohen gjatë pandemisë.



SOCIETIES

SUPPORT OF CSOS IN EMPOWERING TECHNICAL SKILLS.
INCLUSION OF PEOPLE WITH DISABILITIES AND EU STANDARDS
IN SOUTH EAST EUROPE



Funded by the
European Union